



Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbështetjen e kategorive sociale dhe fuqizimin e familjes/individëve në nevojë sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
2. OJQ-të e licencuara nga MFPT/DPSF në Komunën e Gjakovës, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale.
3. Organizatat jo-qeveritare e licencuara mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:
 - 3.1. Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar dhe neglizhuar;
 - 3.2. Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit;
 - 3.3. Shërbime alternative për fëmijë pa kujdes prindëror dhe këshillime për familjet strehuese, për zbatimin e programit të strehimit familjar;
 - 3.4. Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijë;
 - 3.5. Shërbime rezidenciale për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese me këshilla profesionale;
 - 3.6. Shërbime rezidenciale dhe ditore për largimin e fëmijëve nga punët e rënda e të rrezikshme dhe kërkimi i lëmshës;
 - 3.7. Shërbime rezidenciale, ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara;
 - 3.8. Shërbime të rehabilitimit dhe trajtimit për personat me nevoja të veçanta fëmijë dhe të rritur (të verbërit, të shurdhër, tetraplegjike, paraplegjike, me down sindrom, autizëm etj)
 - 3.9. Shërbime të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.

3.10. Shërbime, rezidenciale, ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 10.000 euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është 500 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 10.000 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **06.05 2024**.

6. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner në më së shumti vetëm me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.

7. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. OJQ mund të përfshihet më së shumti në një (1) projekt dhe të përfshihet në zbatimin e vetëm një (1) fushë prioritare.

8. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara dhe duhet të jenë të licencuara sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2020 nga MFPT/DPSF-ja.

9. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktiviteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.

10. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.

11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të, duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Zyra e Kryetarit (**kk.rks-gov.net/gjakove/**).

13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në Adresa: Rr. “UÇK” p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës/ Zyra e Kryetarit”.

14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarit tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

16. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në zyrën e Kryetarit.